



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK) në seancën e 84-të të mbajtur më 30.03.2023 ka miratuar sa vijon

## VENDIM

Denoncimi I regjistruar sipas numrit 12-4007/1 të datës 23.08.2022, **HIDHET POSHT**. KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-4007/1 të datës 23.08.2022 të mbyllet dhe të arkivohet

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë, 13.10.2021, është dorëzuar denoncim dhe në bazë të saj është formuar lënda me numër 12-4007/1 të datës 13.10.2021.

Në denoncim, KSHPK-së i kërkohet të kontrollojë punën e nënës (emrin e së cilës parashtruesi deklaron se nuk e di) të avokatit -----, e cila ajo ishte e punësuar në shërbimin e shpërndarjes së lëndëve gjyqësore sipas sistemit AKMIS. Thuhet se KSHPK-ja mund të përcaktojë se ku janë caktuar shumica e lëndëve sipas gjykimit apo dëshirës së tyre, sepse avokatët kishin frikë të raportonin sepse nuk do t'u caktoheshin rastet.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstaton se denoncimi nuk përmban të dhëna të mjaftueshme për zyrtarin dhe detyrën zyrtare që ai kryen për të verifikuar pretendimet nga denoncimi. Nga sa më sipër, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka pretendime apo paligjshmëri konkrete që tregojnë për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar nga zyrtarë të caktuar, pas së cilës vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Dorëzuar:  
- parashtruesi i denoncimit

përpiloi: B.K.SH.  
Miratoi: N.B., anëtar i KSHPK-së

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОРЁ  
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ  
Nënkryetar  
Katica Nikolovska

